



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 11/2009
Më 07. 04. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Múfera Şinik, Zef Morina dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Slobodan Petroviq, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala dhe Berim Ramosaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Fadil Mustafa – MTI, Petrit Hysa – OSBE, Lumnije Murati Presidenca, Blerina Uka – NDI, Ramadan Klisurica – KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 31. 03. 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë;
4. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 31. 03. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 31. 03. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se ministri Zharku, edhe pse ishte i ftuar me kohë, për shkaqe objektive, nuk ishte i pranishëm në mbledhjen e Komisionit dhe për këtë e kishte njoftuar Komisionin. Ia dha fjalën z. Haki Shatri, raportues për këtë projektligj.

Haki Shatri – Para se ta paraqesë draftraportin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë tha se ka kontaktuar me ministrin Zharku. Për disa dilema të paraqitura në mbledhjen e kaluar, pothuajse ka kompromis, mirëpo ka mbetur që ato të shtjellohen edhe një herë kur të jetë i pranishëm ministri.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Në takimin e radhës së Komisionit të ftohet ministri Lutfi Zharku (MTI), për të dhënë detaje më të qarta për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

IV. Të ndryshme

a) Raportimi i agjencive të pavarura

Kryetarja – I njoftoi deputetët për vendimin e Kryesisë për raportimet e agjencive të pavarura, të cilat i raportojnë Kuvendit. Nga Komisioni kërkoi të caktohet një datë për t'i shqyrtuar raportet e agjencive, të cilat bien në injjirencën e Komisionit.

Ethem Çeku – Kërkoi që në mbledhjen e radhës të caktohet një rend dite dhe të diskutohet për raportet që gjer tani iu kanë adresuar Komisionit.

Zef Morina – Tha se raportet janë çështje të Kuvendit, ndërkaq çështja e mandateve të anëtarëve të bordeve është e ministrive.

Safete Hadergjonaj – Theksoi se çështja e raporteve është punë e Komisionit, sepse agjencitë duhet t’u raportojnë komisioneve, ndërsa për mandatet stafi mbështetës duhet t’ua hartojë një listë të gjitha agjencive dhe ta informojë Komisionin.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori këtë

Përfundim

I. Në mbledhjen e radhës në rend dite të futët për shqyrtim Raporti i KPMM-së.

b) Plani i veprimit

Kryetarja – Kërkoj nga anëtarët e Grupit të Punës ta shqyrtojnë Planin e veprimit dhe ta përfundojnë një raport për këtë çështje.

c) Monitorimi i Ligjit për rrugët

Kryetarja – Kërkoj nga z. Morina të njoftojë për situatën e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për rrugët.

Zef Morina – Theksoi se javën e ardhme do të realizohet një takim zyrtar me Ministrinë e Transportit dhe të Posttelekomunikacionit. Pastaj do të jetë gati edhe raporti.

d) Mbështetja e Komisionit me konsulentë të jashtëm

Kryetarja - E njoftoi Komisionin se Kuvendi do ta mbështetë me një konsulent të jashtëm.

Zef Morina – Tha se duhet të ftohen ekspertë për secilën fushë, sepse nuk mjafton vetëm një ekspert, për shkak të fushave që i mbulon Komisioni.

Safete Hadergjonaj – Shfaq mendimin se do të ishte mirë që Kuvendi të angazhojë ose të kontraktojë ndonjë firmë konsulente, e cila do të ofronte konsulentë të fushave të ndryshme.

Haki Shatri – Tha se duhet të shikohet plani i punës dhe të ofrohen konsulentë në bazë të projektligjeve të planit tremujor.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Konsulenti, sipas fushëveprimtarisë së Komisionit, të caktohet në bazë të nevojave të fushave përkatëse.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani